



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 826/12 Prot.,

Tiranë, më 08.04.2025

VENDIM

Nr. 19, datë 08.04.2025

PËR

**“MIRATIMIN E TREGUESVE TË RISHIKUAR TË BUXHETIT TË VITIT 2025 PËR
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes të programit buxhetor afatmesëm”, Udhëzimit Plotësues nr.4, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”, Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, nenit 48 “Fazat e buxhetimit” të Rregullores “Për administrimin financiar, kontabilitetin dhe kontrollin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Vendimit të përbashkët të GMS-së dhe Rektoratit të UMT-së, nr.03 datë 26.03.2025, Vendimin të Senatit Akademik të UMT-së nr.34, datë 28.03.2025, si dhe relacionit të Administratorit të UMT-së, nr.180/18 prot., datë 02.04.2025 “Dërgohen për miratim treguesit e buxhetit të rishikuar për vitin 2025”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë treguesit ekonomik dhe financiarë të buxhetit të vitit 2025, për Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas tabelave pjesë integrale dhe bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë:
 - Detajimi i shpenzimeve të buxhetit për vitin 2025;
 - Parashikimi i të ardhurave të UMT-së, sipas njësive shpenzuese dhe programeve;
 - Numri i planifikuar të punonjësve;
 - Shpenzimet e pagave për çdo njësi;
 - Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
 - Shpenzimet e llogarisë së mallrave dhe shërbimeve;
 - Shpenzimet për investime;
 - Shpenzimet për bursa;
 - Balanca e të ardhurave dhe shpenzimeve;

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ

